

KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

Sot më datë 13/02/2019 lidhet kjo kontratë dhurimi aksionesh (“**Kontrata**”) ndërmjet palëve të mëposhtme (veçmas referuar si “**Pala**” dhe bashkërisht si “**Palët**”):

DHURUESI: Z. Amarildo Hasrama, shtetas shqiptar, vendlindja Tiranë, i datëlindjes 11.06.1990, i identifikuar me pasaportën nr. BE5032160, me nr. personal J00611092A.

PRANUESI
DHURIMIT: Z. Jetnor Sinomati, shtetas shqiptar, vendlindja Tepelenë, i datëlindjes 26.03.1973, i identifikuar me letërnjoftimin nr. 031029592, me nr. personal H30326140W.

PREAMBULA:

- A) Dhuruesi është aksionar në shoqërinë ENERG COMPANY Sha, NUIS L91405045M, me seli në TIRANE Rruga Don Bosko, perballë Kishes Katolike, pallati Aurora, kati I (në vijim referuar si “**Shoqëria**”), dhe zotërues i një pjesëmarrjeje prej 70% të kapitalit të Shoqërisë, e përbërë nga 245 aksioneve të zakonshme me vlerë nominale 10.000 Lekë secila;
- B) Dhuruesi dëshiron t’i dhurojë Pranuesit të Dhurimit, i cili është dakord, 25 aksione të zakonshme të Shoqërisë me vlerë nominale 10.000 Lekë secila, sipas kushteve të kësaj Kontrate;

Në këto kushte, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 – Objekti i dhurimit

- 1.1 Objekt i kësaj Kontrate është dhurimi pa asnjë kusht dhe kalimi në favor të Pranuesit të Dhurimit i 25 aksioneve të zakonshme të Shoqërisë me vlerë nominale 10.000 Lekë secila dhe vlerë nominale pjesëmarrjeje prej 250.000 Lekë. Pas dhurimit të aksioneve sipas përcaktimeve të këtij neni, ndarja e aksioneve mes aksionarëve të Shoqërisë është si më poshtë vijon:
 - a) Z. Amarildo Hasrama zotëron 220 aksione të zakonshme me vlerë nominale 10.000 Lekë secila;
 - b) Z. Jetnor Sinomati zotëron 25 aksione të zakonshme me vlerë nominale 10.000 Lekë secila;
 - c) Z. Benar Halilaj zotëron 105 aksione të zakonshme me vlerë nominale 10.000 Lekë secila.

Neni 2 - Dhurimi

- 2.1 Palët bien dakord se me nënshkrimin e kësaj Kontrate nga Palët, Pranuesi i Dhurimit bëhet pronar dhe zotërues me të drejta të plota i aksioneve të dhuruara, sipas përcaktimit të nenit 1 më sipër, dhe Dhuruesi zhvishet nga çdo e drejtë e detyrim në lidhje me aksionet e dhuruara.

Neni 3 – Dispozita të ndryshme

- 3.1 Kjo kontratë dhurimi hyn ne fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe përbën të gjithë marrëveshjen mes Palëve lidhur me objektin e saj.
- 3.2 Palët bien dakord qe kjo kontratë dhurimi do te zbatohet dhe interpretohet ne përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk parashikohet në këtë kontratë dhurimi do të zbatohen parashikimet e Kodit Civil te Republikës së Shqipërisë mbi dhurimin.
- 3.3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane do të jetë kompetente për te gjykuar mosmarrëveshjet qe Palët nuk mund t'i zgjidhin me mirëkuptim ndërmjet tyre.
- 3.4 Kjo kontratë dhurimi regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Kjo Kontrate Dhurimi hartohet dhe nënshkruhet nga Palët ne 2 (dy) ekzemplarë të njëjtë ne gjuhen shqipe.


DHURUESI

Z. Amarildo Hasrama

Amarildo Hasrama


PRANUESI I DHURIMIT

Z. Jetnor Sinomati

Jetnor Sinomati


Unë aksionari i Shoqërisë Benar Halilaj jam dakord me dhurimin e aksioneve sipas kësaj Kontrate dhe kalimin e tyre në favor të Pranuesit të Dhurimit Z. Jetnor Sinomati, duke hequr dorë nga çdo e drejtë parablerje sipas statutit të Shoqërisë.

BENAR HALILAJ

Benar Halilaj

